

Vaksinat për mbrojtje kundër HPV, MenACWY dhe Tdap

Informacion për prindërit dhe nxënësit në vitin e parë të shkollës së mesme (që përkon me klasën e 7-të në Gjeorgji)

Rreth kësaj broshure

Kjo broshurë është për prindërit dhe nxënësit dhe shpresojmë ta lexoni së bashku. Ekipet e HSE-së të vaksinimit në shkolla do të ofrojnë vaksinat HPV, Tdap dhe MenACWY për të gjithë nxënësit në vitin e parë - djem dhe vajza. Ne kemi nevojë që prindërit dhe kujdestarët të lexojnë, të nënshkruajnë dhe të kthejnë një formular të shkurtër, për të treguar se janë dakord që fëmija i tyre t'i marrë këto vakcina. Ky formular quhet "Formulari i pëlqimit të vaksinimit për fëmijët që fillojnë vitin e parë të shkollës së mesme".

Informacionet e përfshira në këtë broshurë:

- Vaksinat që u ofrohen nxënësve të vitit të parë – nga çfarë mbrojnë ato dhe dozat e nevojshme
- Vizitat e ekipeve të vaksinimit në shkolla
- Pyetjet më të zakonshme
- Ku mund të gjeni më shumë informacione
- Formulari i pëlqimit

Nëse keni një pyetje si prind ose si nxënës në lidhje me ndonjë pjesë të kësaj broshure, ju lutemi kontaktoni një anëtar të ekipit të vaksinimit. Numri i telefonit të ekipit tuaj lokal është i përfshirë në këtë paketë.

Vaksinat që ne ofrojmë

Vaksina është një substancë që krijon imunitet (mbrojtje) ndaj një sëmundjeje të veçantë. Janë tre vakcina që ofrohen për të mbrojtur nga sëmundjet infektive.

Vaksina HPV ofron mbrojtje kundër virusit HPV i cili mund të shkaktojë kancer si te vajzat, ashtu edhe te djemtë.

Vaksina MenACWY ofron mbrojtje kundër katër llojeve të sëmundjes së meningokokut, të cilat mund të shkaktojnë meningjit (inflamacion i cipës rrethuese të trurit) dhe/ose septicemi (helmimi i gjakut).

Vaksina Tdap e cila ofron mbrojtje kundër:

- tetanozit (toksina e tetanozit mund të shkaktojë spazma të dhimbshme muskulore dhe konvulsione/të dridhura)
- difterisë (baktere që mund të shkaktojnë dhimbje të fytit dhe vështirësi të rënda në frymëmarrje) dhe
- pertusis (një bakter i njohur gjithashtu si kollë e mirë dhe shkakton kollë të rëndë dhe të vjella)

Vaksina HPV: ofron mbrojtje kundër kancerit

Vaksina MenACWY: ofron mbrojtje kundër meningjitit

Tdap: ofron mbrojtje kundër tetanozit, difterisë dhe kollës së mirë

Vizita e ekipeve të vaksinimit në shkolla

Ekipet e HSE-së të vaksinimit në shkolla do të shkojnë nëpër shkolla për t'u bërë vaksinat nxënësve. Vaksinat që bëhen janë:

- Vaksina HPV
- Vaksina Tdap
- Vaksina MenACWY

Vaksina HPV bëhet në njërin krah dhe vaksinat Tdap dhe MenACWY bëhen në krahun tjetër me një hapësirë midis tyre.

Vaksinat - më shumë hollësi për çdo vaksinë HPV – për vajzat dhe djemtë

Çfarë është HPV?

HPV është shkurtim i termit 'human papillomavirus' (virusi i papilomës njerëzore), i cili është një grup që përfshin më shumë se 100 viruse. Virus HPV është shumë i zakonshëm; shumica e njerëzve do të infektohen me një formë të HPV gjatë jetës së tyre. Ju mund të merrni virusin HPV duke qenë seksualisht aktiv me një person tjetër që tashmë e ka virusin.

Shumica e infeksioneve me HPV nuk kanë nevojë për trajtim. Megjithatë, në disa njerëz, infeksioni HPV mund të vazhdojë dhe të shkaktojë kancer. HPV shkakton gjithashtu lytha në organet gjenitale.

Infektimi është shumë i zakonshëm si te gratë, ashtu edhe te burrat, ku më shumë se 80% e njerëzve do të marrin një infeksion HPV gjatë jetës së tyre.

Vaksina HPV mbron kundër kancerit të qafës së mitrës dhe llojeve të tjera të kancerit. Vaksina HPV quhet Gardasil 9.

Pse jepet vaksina HPV?

Komiteti Këshillimor Kombëtar i Imunizimit (NIAC) rekomandon që të gjithë fëmijët e moshës 12-13 vjeç duhet të marrin vaksinën HPV në programin e vaksinimit në shkollë, në mënyrë që të mbrohen nga llojet e kancerit që shkaktohen nga HPV kur të jenë të rritur.

NIAC thotë se ekziston një lidhje midis infeksionit HPV dhe kancerit të qafës së mitrës, vaginës dhe vulvës tek gratë dhe kancerit të kokës e kancerit të qafës (pjesa e pasme e fytit, duke përfshirë bazën e gjuhës dhe bajamet), si dhe kancerit anal si te burrat, ashtu edhe tek gratë dhe kancerit të penisit te burrat.

Cilat shtete e bëjnë vaksinën HPV?

140 shtete kanë tani një program vaksinash HPV, ku më shumë se 50 nga këto shtete e japin vaksinën për djemtë dhe vajzat. Në këto shtete përfshihen:

- Australia
- Italia
- Zelanda e Re
- Norvegjia
- Mbretëria e Bashkuar
- SHBA

Më shumë informacione rreth suksesit të këtyre të vaksinimit jepen në faqen e internetit www.hpv.ie

Vaksina HPV jepet në 140 shtete për të parandaluar disa lloje kanceri

Vaksina HPV u ofrohet djemve dhe vajzave në vitin e parë.

Çfarë llojesh kanceri mund të shkaktojë HPV?

Virusi HPV mund të shkaktojë një sërë lezionesh parakanceroze – qeliza anormale – si te burrat, ashtu edhe te gratë. Virus HPV shkakton:

- pothuajse të gjitha llojet e kancerit të qafës së mitrës
- 5 nga 10 llojet e kancerit të vulvës
- 7 nga 10 llojet e kancerit vaginal
- 9 nga 10 llojet e kancerit anal të lidhura me HPV
- 9 nga 10 rastet e lythave gjenitale.

Hulumtimet kanë treguar se infeksioni HPV është gjithashtu i lidhur me kancerin e:

- gojës dhe fytit (orofaringu)
- pjesës së fundit të zorrës së trashë (rektumi)
- penisit

HPV shkakton 1 në 20 kancera në mbarë botën

Mbi 550 000 nxënës në Irlandë dhe 100 milionë njerëz në mbarë botën kanë marrë vaksinën HPV

Sa doza të vaksinës HPV nevojiten?

NIAC ka rekomanduar që vetëm një dozë e vaksinës HPV nevojitet për shumicën e njerëzve përmes programit të vaksinimit në shkollë.

Për personat që kanë një sistem imunitar dukshëm të dobët rekomandohen 3 doza të vaksinës HPV. Kjo duhet të diskutohet me specialistin e fëmijës suaj.

Viti i parë në shkollën e mesme është koha më e mirë për të bërë vaksinën, pasi ajo është më efektive në këtë moshë.

Vaksina MenACWY

Çfarë është sëmundja e meningokokut?

Sëmundja e meningokokut është një sëmundje serioze e cila mund të shkaktojë meningjit (inflamacion i cipës rrethuese të trurit) dhe septicemi (helmim gjaku) dhe mund të çojë në vdekje. Ekzistojnë një sërë llojesh të ndryshme bakteresh të meningokokut dhe të gjithë fëmijët duhet të kenë marrë një vaksinë për t'u kundër baktereve të meningokokut të grupit C kur kanë qenë foshnja.

Vaksina MenACWY do të përforcojë mbrojtjen kundër sëmundjes së meningokokut të grupit C. Ajo do të sigurojë gjithashtu mbrojtje shtesë kundër meningokokut të grupeve A, W dhe Y. Përveç kësaj, kjo vaksinë redukton rrezikun e bartjes së sëmundjes, kështu që mund të ndihmojë për të mbrojtur edhe njerëzit e tjerë.

Vaksina MenACWY quhet Nimenrix.

Kjo vaksinë nuk mbron ndaj të gjitha grupeve të baktereve të meningokokut, p.sh. grupi B, ose ndaj baktereve të tjera që mund të shkaktojnë meningjtin, prandaj është e rëndësishme që të njihni edhe simptomat që duhet të kërkoni dhe të kërkoni kujdes mjekësor urgjent.

Sëmundja e meningokokut mund të fillojë krejt papritur. Simptomat përfshijnë ethe, ngrirje të qafës, dhimbje koke, dhimbje kyçesh dhe skuqje të lëkurës. Sëmundja e meningokokut mund të shfaqet në çdo moshë, por shkalla më e lartë e sëmundjes shfaqet te fëmijët nën moshën 5, në veçanti te fëmijët nën 1 vjeç.

Grupi tjetër me rrezikun më të lartë janë të rinjtë e moshës 15-19 vjeç.

Sa doza të vaksinës MenACWY nevojiten?

Për mbrojtje nevojitet vetëm një dozë e vaksinës MenACWY.

Vaksina Tdap

Çfarë është Tdap?

Tdap është një shkurtime për tetanoz, difteri dhe pertusis (kolla e mirë).

Kjo vaksinë ofron mbrojtje kundër baktereve dhe toksinave të dëmshme. Vaksina Tdap quhet Boostrix.

Tetanozi mund të shkaktojë spazma të dhimbshme muskulore, konvulsione/të dridhura dhe bllokim të nofullës (vështirësi në hapjen e gojës për shkak të spazmave të muskujve) që çojnë në vështirësi në frymëmarrje dhe vdekje.

HPV, Tdap and MenACWY 1st Yr Programme Albanian

Difteria është një sëmundje serioze që zakonisht fillon me dhimbje të fytit dhe mund të zhvillohet shpejt për të shkaktuar probleme me frymëmarrjen. Mund të dëmtojë gjithashtu zemrën dhe sistemin nervor.

Pertusis (kolla e mirë) është një sëmundje që mund të shkaktojë periudha të gjata me kollitje, mbytje dhe të vjella që mund të vështirësojnë frymëmarrjen.

Të gjitha këto infeksione janë sëmundje serioze që mund të çojnë në shtrimin në spital. Në rastin më të keq, këto kushte mund të shkaktojnë vdekje.

Sa doza të vaksinës së difterisë, tetanozit dhe kollës së mirë nevojiten për mbrojtje të plotë?

Deri në moshën gjashtë vjeç, çdo fëmijë duhet të ketë marrë katër doza të vaksinës kundër tetanozit, difterisë dhe pertusisit (kollë e mirë)

- që do të thotë:

- 3 doza si bebe
- një dozë përforcuese të fëmijët e vegjël

Imuniteti ndaj këtyre sëmundjeve zvogëlohet me kalimin e kohës, prandaj për të siguruar mbrojtje shtesë rekomandohet një dozë përforcuese.

Doza përforcuese është një dozë shtesë ose plotësuese. Kjo është doza e tyre e pestë dhe e fundit dhe do t'u japë atyre mbrojtje afatgjatë.

Pesë dozat do të plotësojnë ciklin tuaj

Pyetjet më të zakonshme

A mundet një nxënës/e të presë derisa të jetë më i/e rritur që të marrë vaksinat HPV, MenACWY ose Tdap?

Programi i HSE-së në shkolla ofron vaksinat HPV, MenACWY dhe Tdap për nxënësit në vitin e parë të shkollës së mesme. Këtë vit, HSE po ofron një mundësi tjetër për njerëzit që të marrin vaksinën HPV përmes programit të vaksinimit plotësues të HPV "Laura Brennan". Më shumë detaje jepen në faqen e internetit www.hpv.ie

Megjithatë, ky program plotësues do të përfundojë në dhjetor 2023. Nëse vendosni të prisni derisa fëmija juaj të jetë më i rritur për t'u vaksinuar, do t'ju duhet të vaksinoni fëmijën tuaj nëpërmjet mjekut tuaj të përgjithshëm (mjeku lokal) dhe do të duhet të paguani një tarifë administrimi dhe për vaksinat.

A do të regjistrohen vaksinat që kam marrë?

Po. Në ditën e vaksinimit, pasaportat e vaksinimit do të përditësohen nga ekipi i vaksinimit të shkollës. Nëse nuk keni pasaportë vaksinimi, një anëtar i ekipit të imunizimit do t'ju japë një të tillë pas vaksinimit.

Si mund të përgatiten nxënësit për ditën e vaksinimit?

Në ditën e vaksinimit, nxënësit duhet:

- Të hanë mëngjes
- Të veshin një bluzë të lirë me mëngë të shkurtra

Nga ta dimë që vaksinat janë të sigurta?

Të gjitha vaksinat janë të sigurta dhe kanë vërtetuar se shpëtojnë jetë dhe parandalojnë sëmundje të rënda.

Vaksinat monitorohen rreptësisht dhe rishikohen rregullisht nga organet ndërkombëtare duke përfshirë:

- Organizatën Botërore të Shëndetësisë
- Agjencinë Evropiane të Barnave
- Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve në SHBA

Të gjitha organizmat ndërkombëtare kanë raportuar në vazhdimësi se vaksinat e përdorura në Irlandë janë të sigurta, pa efekte anësore afatgjata të njohura.

A kanë vaksinat efekte anësore afatshkurtra?

Shumica e nxënësve nuk kanë asnjë problem pas vaksinave. Disa nxënës mund të kenë një vend që i dhemb, ënjtje dhe skuqje në krahun e tyre, aty ku është bërë injeksioni. Disa nxënës mund të kenë dhimbje koke, të ndihen të sëmurë në bark ose të kenë një temperaturë të lehtë. Kjo nuk është asgjë për t'u shqetësuar, pasi kjo zakonisht kalon pas një ose dy ditësh.

A kanë vaksinat efekte anësore afatgjata?

Nuk ka efekte anësore afatgjata të dokumentuara.

ku mund të merrni më shumë informacion

Nëse keni ndonjë pyetje, ju lutemi t'i diskutoni ato me një anëtar të ekipit të HSE-së të imunizimit në shkollë, me infermieren tuaj ose me mjekun tuaj të përgjithshëm (mjekun). Detajet e kontaktit të ekipit të imunizimit mund t'i gjeni në këtë paketë.

Mund të vizitoni gjithashtu faqen e internetit www.hpv.ie dhe www.immunisation.ie për video dhe fakte rreth vaksinave. Ju nxisim të lexoni broshurën "Faktet rreth vaksinave për nxënësit që fillojnë shkollën e mesme", në faqen tonë të internetit.

Gjithashtu mund të gjeni lidhjet për në broshurat e informimit të pacientit për vaksinat, në faqen e internetit www.hpra.ie.

Kërkoni për Gardasil 9 (HPV), Nimenrix (MenACWY) ose Boostrix (Tdap), për të lexuar broshurën përkatëse të informimit të pacientit.

Formulari i pëlqimit për vaksinat

Ju duhet të lexoni dhe të nënshkruani formularin e pëlqimit në këtë paketë dhe ta ktheni atë në shkollë, për t'u siguruar që fëmija juaj të marrë vaksinat në shkollë. Mund të përdorni zarfin e ofruar për ta kthyer formularin në shkollë.